

## **TERMAT DHE KUSHTET PËR KARTËN CINEPLEXX BONUS CARD**

### **1. HYRJE**

Cineplexx Kosovo L.L.C, zona e re Industriale, Albi Mall, Prishtinë, lëshon dhe administron kartat Cineplexx Bonus Card (në vijim: kartat CBC), respektivisht kartën CINEPLEXX BONUS CARD RED (në vijim: CBC RED) dhe kartën CINEPLEXX BONUS CARD BLACK (në vijim: CBC BLACK), si dhe administron pikët bonus, të cilat mblidhen nga blerja e biletave të kinemasë dhe produkteve të banakut, duke paraqitur kartën CBC.

### **2. REGJISTRIMI**

Për përdorimin e kartës CBC duhet bërë regjistrimi online në aplikacionin e Cineplexx KS (Android dhe iOS).

Pas përfundimit të regjistrimit, karta e personalizuar CBC mund të tërhiqet pranë arkës në kinema.

### **3. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE**

Duke u regjistruar, klienti bie dakord që të dhënat e bëra të ditura prej tij, si dhe informacioni mbi vizitat e tij në kinema, të identifikuara nga karta CBC të mblidhen në mënyrë të automatizuar, të shkëmbehen e shpërndahen nga Cineplexx Kinobetriebe GmbH "ATU64486522", Cineplexx Kosovo LLC "810864232", Herton Digital GmbH "ATU48888501", Cinepromotion, Filmmarketing GmbH "ATU40203409", MOVIO LTD, Netural GmbH "ATU66710856", dhe Vista Entertainment Solutions.

#### **2.**

Mbledhja, shkëmbimi e shpërndarja e këtyre informacioneve përdoren vetëm për prodhimin dhe pajisjen e klientit me kartën CBC, kujdesin për klientin, për qëllime marketingu dhe informimin e klientit mbi fushatat dhe ofertat aktuale të kartës CBC. Klienti mund të tërheqë, në çdo kohë, miratimin e dhënë për marrjen e mesazheve elektronike komerciale. Me përjashtim të rastit të mbushjes së kreditit në kartën CBC dhe të kohëzgjatjes prej 18 muajsh, klienti mund të tërheqë edhe miratimin për procedimin dhe përdorimin e mëtejshëm të të dhënave të tij personale, duke komunikuar me email në adresën e emailit: [bonuscard@ceneplexx-ks.eu](mailto:bonuscard@ceneplexx-ks.eu). Brenda një periudhe prej 10 ditësh pune pas marrjes së kërkesës, të gjitha të dhënat personale fshihen nga sistemi CBC, por nëpërmjet këtij veprimi humbet edhe vlefshmëria e kartës CBC.

### **4. AVANTAZHET E KARTËS CBC**

#### **a.) Kartat CBC pa parapagesë - funksioni**

Me anë të kartës CBC – edhe në rastet kur nuk është mbushur sipas funksionit prepaid -, përdoruesi ka mundësinë të mbledhë pikët bonus, të cilat, në kuadër të programit të besnikërisë mund të këmbehen me shpërblime për një numër të caktuar pikësh bonus.

Në aplikacionin mobil Cineplexx KS dhe në sportelet e kinemasë, përdoruesit e kartave CBC mund të marrin informacion mbi gjendjen aktuale të pikëve të mbledhura, informacione mbi shpërblimet, të cilat mund të përfitohen nga pikët e mbledhura si dhe informacione mbi numrin e nevojshëm të pikëve për marrjen e shpërblimeve tjera.

Shpërblimet përkatëse mund të përfitohen dhe të tërhiqen vetëm në sportelin e kinemasë.

b.) Karta CBC me parapagim (funksioni prepaid)

Me mbushjen e kartës paraprakisht, klienti gëzon edhe këto avantazhe shtesë:

- Mundësinë e blerjes online të biletave të kinemasë duke përfituar nga reduktimi i çmimit të rregullt të biletave të kinemasë. Lista e shpërblimeve mund të shikohet në aplikacionin Cineplexx KS (iOS dhe Android) dhe te arka e kinemasë.

Të drejtën për të përfituar nga ulja e çmimit e shpjeguar më sipër e kanë vetëm ata përdorues të kartës, të cilët i paguajnë biletat e kinemasë duke përdorur kreditin e transferuar paraprakisht në kartën CBC. Për pagesat me para në dorë ose kartë banke nuk garantohej ulje çmimi për biletat e kinemasë, por grumbullohen pikë bonus nga blerja.

Gjatë blerjes fizike në arkat e kinemasë, nëse krediti në kartën CBC RED nuk mjafton për të blerë biletën e kinemasë (me çmim të reduktuar), diferenca e çmimit të reduktuar mund të paguhet në mënyrë tjetër (me para në dorë ose pagesa elektronike). Me kartën CBC mund të blini ushqim dhe pije me çmim të rregullt.

Informacioni mbi kreditin në kartën CBC mund të merret në çdo kohë në aplikacionin Cineplexx KS ose në sportelin e kinemasë.

## **5. VLEFSHMËRIA E KREDITIT DHE PIKËVE BONUS**

Përdorimi i shumës së kredituar në kartën CBC për blerjen e drejtpërdrejtë dhe me çmim të reduktuar të biletave të kinemasë, si dhe për blerjen e drejtpërdrejtë të artikujve nga bari i kinemasë është i kufizuar brenda një periudhe 18-mujore nga mbushja e kartës. Pjesa e mbetur e kreditit mund të përdoret në formë të Gift Card edhe 60 muaj në vijim për blerjen e drejtpërdrejtë (sidokoftë jo me çmim të reduktuar) të biletave të kinemasë. Pas kalimit edhe të këtij afati pesëvjeçar, klienti e humb të drejtën për shfrytëzimin e të hollave në kartë. Krediti fillestar do të mund të riaktivizohet nëpërmjet rimbushjes së kartës suaj CBC me një minimum prej 20€ brenda 60 muajve.

Pikët e grumbulluara nga karta CBC mund të përdoren brenda 18 muajve. Pas këtij afati prej 18 muajsh, këto pikë skadojnë, ndërsa pikët e tjera, të cilat janë brenda afatit prej 18 muajsh, e ruajnë vlefshmërinë dhe mund të përdoren (derisa edhe këto pikë të arrijnë afatin e përdorimit).

Për sa kohë në kushtet e biznesit nuk është përcaktuar qartësisht ndryshe, krediti dhe pikët bonus nuk rimbursohen në para dhe as nuk mund të tërhiqen në cash apo të transferohen në një kartë tjetër CBC.

Për kreditin në kartën CBC nuk aplikohet interes.

## **6. KARTA CBC BLACK**

Kartën CBC BLACK e përfitojnë ata klientë, të cilët, brenda një viti kalendarik, kanë blerë më shumë se 30 bileta duke përdorur kartën CBC RED.

Këmbimi i kartës CBC RED me kartën CBC BLACK realizohet në vizitën e radhës në kinema, pasi klienti ka blerë 30 bileta kinemaje me kartën CBC RED. Karta CBC BLACK është e vlefshme nga data e lëshimit deri më 31 dhjetor të vitit vijues dhe, nëse përdoruesi i kësaj karte gjatë vitit blen, të paktën, edhe 30 bileta të tjera kinemaje, zgjat edhe me një vit tjetër kalendarik.

Karta CBC BLACK mund të kthehet sërish në kartë CBC RED dhe këmbehet edhe fizikisht në vizitën e radhës në kinema, në qoftë se me kartën CBC BLACK brenda një viti kalendarik nuk blihen të paktën 30 bileta kinemaje.

Përveç avantazheve të kartës CBC RED, karta CBC BLACK ofron edhe 10% zbritje në produktet ushqimore të cilat paguhen me kredit të kartelës, si dhe avantazhe të tjera, të cilat janë të publikuara në aplikacionin mobil Cineplexx KS dhe në sportelin e kinemasë.

## **7. RREGULLA TJERA**

Brenda një dite, me anë të kartës CBC mund të blihen maksimalisht dy bileta. Pikët bonus grumbullohen në rast se blihen bileta kinemaje (maksimalisht 2 në ditë), por jo kur thjesht mbushet karta me kreditin prej 20€, 35€ ose 50€ (sigurisht që pikët bonus mbledhen në rast se ky kredit përdoret për blerjen e biletave dhe produkteve të kinemasë). Kompania gëzon të drejtën të ndërmarrë e prezantojë aksione të veçanta për mënyrën dhe mundësinë e mbledhjes së pikëve bonus.

Për ta përdorur kartën CBC për oferta, ulje çmimi dhe mbledhjen e pikëve bonus, karta CBC duhet paraqitur përpara kryerjes së pagesës së biletave në sportelin e kinemasë ose në aplikacionin e Cineplexx KS. Llogaritja më pas, pa vendosur të dhënat e kartës CBC, është e pamundur. Limiti ditor për të mbledhur pikë bonus nga blerje e ushqimeve dhe pijeve është 500, ndërsa limiti ditor për të mbledhur pike bonus nga blerja e biletave është 150.

Uljet e çmimeve të biletave të kinemasë për blerjet me kreditin prej 50€, 35€ apo 20€ në kartën CBC vlejnë për filma me metrazh normal, që do të thotë për filmat që zgjasin deri në dy orë. Në kinemanë në Prishtinë për filmat me metrazh më të gjatë mund të rritet çmimi i biletës për + 0,40€ për filmat mbi 120 min, + 0,90€ për filmat mbi 140 min dhe +1,20€ për filmat mbi 180 min. Për biletat e filmave 3D llogariten deri në + 1,10€, ndërsa për vende të kategorive të veçanta (p.sh. vendet VIP) një tarifë shtesë deri në + 1,00€. Ndërsa, në kinemanë në Prizren për filmat me metrazh më të gjatë mund të rritet çmimi i biletës për + 0,30€ për filmat mbi 120 min, + 0,80€ për filmat mbi 140 min dhe +1,00€ për filmat mbi 180 min. Për biletat e filmave 3D llogariten deri në + 1,10€, ndërsa për vende të kategorive të veçanta (p.sh. vendet VIP, LoveBox) një tarifë shtesë deri në + 1,00€. Të gjitha tarifat shtesë llogariten duke

përfshirë TVSh-në. Për Pre-Premiera të filmave është i vlefshëm çmimi i Pre-Premieres, i publikuar në sportelet e kinemave ose në faqen e internetit [www.cineplexx-ks.eu](http://www.cineplexx-ks.eu).

Karta CBC nuk është e vlefshme për shfaqje të veçanta dhe prepremiera (shfaqjet gala, transmetimet satelitore, koncertet, baletet, operat, transmetimet sportive).

Përdoruesi i kartës CBC duhet ta mbajë e ta ruajë atë me kujdes dhe sipas rregullave. Në rast humbjeje a dëmtimi të kartës CBC, përdoruesi i kartës është i detyruar të njoftojë me shkrim kompaninë në e-mail adresën [bonuscard@cineplexx-ks.eu](mailto:bonuscard@cineplexx-ks.eu), në mënyrë që karta të bllokohet e të nisin procedurat për pajisjen me kartë të re. Me përjashtim të rasteve kur dëmtimi i kartës është shkaktuar nga persona të kompanisë, përdoruesi i kartës është përgjegjës drejtpërdrejt për disavantazhet e shkaktuara nga humbja apo dëmtimi i kartës deri në njoftimin me shkrim të kompanisë. Karta e re CBC do të ketë të njëjtin kredit, pasi të paguhet një shume prej 2 Eur, me kreditin në momentin e deklarimit dhe do të jetë e vlefshme për aq kohë sa ç'ishte edhe karta e vjetër e humbur apo e dëmtuar.

Personeli i kinemasë ka të drejtën, por jo detyrimin të shohë dokumentin identifikues të përdoruesit, për të verifikuar se identiteti i personit është i njëjtë me atë të personit në kartë.

## **8. NDRYSHIMI/ZGJIDHJA E KONTRATËS**

Kompania gëzon të drejtën e ndryshimit të këtyre kushteve, veçanërisht të kushteve të pjesëmarrjes në sistemin e grumbullimit të pikëve bonus si dhe të kushteve që lidhen me reduktimin e çmimit të biletave nëpërmjet kartës CBC. Në rast ndryshimi apo përditësimi të këtyre kushteve, këto ndryshime bëhen të ditura që nga dita e hyrjes në fuqi të tyre, nëpërmjet postës elektronike në adresën e emailit që përdoruesi ka deklaruar gjatë regjistrimit ose në adresën e fundit të emailit të bërë të ditur prej tij, në afishimet e sporteleve të kinemave si dhe në faqen e internetit: [www.cineplexx-ks.eu](http://www.cineplexx-ks.eu). Në rast se ndryshimet e kushteve nuk janë në dobi të tij, përdoruesi ka të drejtë ta dorëzojë kartën CBC në vizitën e ardhshme në kinema dhe të kërkojë pagesën e kreditit të mbetur në kartë në formë të Gift Card, të cilën mund ta përdorë për blerje të produkteve në Cineplexx me çmim të rregullt.

Marrëveshja kontraktuale për kartën CBC është në thelb një kontratë me afat të papërcaktuar (me përjashtim të paragrafit vijues në lidhje me kreditin prepaid të vendosur në kartë). Kjo do të thotë se kjo kontratë mund të zgjidhet si nga klienti, ashtu edhe nga kompania duke respektuar një afat tremujor në fund të çdo date 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të vitit përkatës. Zgjidhja e kontratës nga përdoruesi i kartës bëhet me email në adresën e mëposhtme të emailit. [bonuscard@cineplexx-ks.eu](mailto:bonuscard@cineplexx-ks.eu) dhe në adresën e emailit të kompanisë, të cilën kjo e fundit ia ka bërë të ditur klientit. Një muaj pas zgjidhjes së kontratës, klienti nuk ka më mundësi për të përfituar pikë bonus shtesë, përfitimi i pikëve bonus të mbledhura paraprakisht është i mundur deri në fund të marrëveshjes kontraktuale.

Vlefshmëria e kreditit ekzistues sipas pikës 5 nuk preket. Konvertimi i kreditit për blerjen e biletave të kinemasë me ulje – siç parashikohet në pikën 5 – përfundon 18 muaj pas lëshimit të kartës. Krediti i papërdorur në përfundim të këtij afat mund të përdoret për blerjen e biletave të kinemasë, por pa përfituar ulje çmimi.

## **9. VLEFSHMËRIA**

Nëpërmjet regjistrimit për marrjen e një karte të personalizuar dhe përdorimin e kartës CBC, klienti bie dakord me kushtet e përgjithshme të biznesit.